



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK
TIRANË


Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 26/11/ 2009

BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI
PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI


Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 26 Nentor 2009.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 47 të vitit 2008 dhe të vitit 2009. Numri i rasteve. (përkatesisht deri me dt. 22. 11. 2009).



- Aktualisht jemi ne fazen e aktivitetit epidemik.
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore akute verehet ne moshat feminare.


Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




- Numri javor i rasteve te infeksioneve respiratore te raportuara ka arritur pragu epidemik
- Lidhur me gripin e ri A/H1N1, deri ne daten 26 Nentor 2009, jane marre 1878 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 15 - 24 vjeç ku dhe vihet re dhe numri me i madh i rasteve te konfirmuara.
- Numri i pergjithshem i rasteve te konfirmuara me virusin A(H1N1) deri ne daten 26 Nentor 2009 eshte **190**. Moshja mesatare e rasteve te prekura ne total eshte 21 vjeç ndersa e rasteve te javes se fundit eshte 17.5 vjeç. Shumica derrmuese e rasteve jane konfirmuar ne Tirane.
- Perveç virusit te Gripit te Ri Pandemik A/H1N1 cdo dite konfirmohen raste me virusin e Gripit te Zakonshem Stinor cka deshmon qarkullimin e perbashket e te dy viruseve ne popullate. Rreth nje e treta e rasteve te konfirmuara laboratorikisht jane grip A stinor.
- Shenjat klinike te rasteve te konfirmuara gjate dy javeve te fundit kane qene te lehta dhe mesatare. Eshte regjistruar nje rast i rende (sindrom i rende respirator akut), i shtruar ne spitalin pneumoftiziatrik dhe nje rast tjeter i rende me gripin stinor i shtruar ne Spitalin Infektiv, QSUT.

- Survejanca ne te gjithë vendin është përfunduar me informacionin mbi shtrimet ne te gjitha spitalet e vendit dhe është përforcuar survejanca për zbulimin dhe monitorimin e rasteve me semundje të rënda respiratore.


Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas javës së raportimit



Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas grupmoshës



Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas rretheve



Frekuenca e hasjes së Infeksioneve Respiratore (të Sipërme dhe të Poshtëme) sipas rretheve në javën e 46-të dhe javën e 47-të të vitit 2009. Incidenca (raste/10.000)

